

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datë / Izlaze: Date / Dana: 17.07.2025

Nr. Orgv. Org. jed.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqeve. Br. Strana.
09	194	3

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik për Projekt-Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi

Data: 10 korrik 2025

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës, Ferizaj

Më datë 10 korrik 2025, në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, është mbajtur konsultimi publik lidhur me **Projekt-Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi**.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të kompanive të taksive dhe autotaksive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e komunës, me qëllim të adresimit të komenteve, sugjerimeve dhe shqetësimeve të tyre në lidhje me përmbajtjen e rregullores së propozuar.

Takimi është udhëhequr nga **Alberton Sahiti**, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ndërsa pjesëmarrës tjerë institucionalë ishin:

- **Arsim Aliu**, zyrtar i lartë për çështjet e komunikacionit,
- **Agon Kamenica**, inspektor i komunikacionit,
- **Shyhrete Topalli-Rexhepi**, udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në hapje të takimit, drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Alberton Sahiti, theksoi se përmes kësaj rregulloreje përcaktohen rregullat strikte për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

“Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit dhe kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Komunës së Ferizajt. Rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij shërbimi e realizon Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit”, tha drejtori Sahiti.

Pjesë e takimit ishte edhe zyrtari i lartë për komunikacion, Arsim Aliu, i cili i informoi pjesëmarrësit në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e rregullores.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit shprehën interesim të madh për përmbajtjen e projekt-rregullores, veçanërisht për:

- kriteret për licencim dhe rinovimin e licencave për taksi,
 - mënyrën e përcaktimit të stacioneve të pritjes,
 - kontrollet inspektuese dhe zbatueshmërinë e rregullores në praktikë,
 - rregullimin e çmimeve dhe pajisjen me taksimetër,
 - qartësimin e detyrimeve të operatorëve dhe bashkëpunimin me komunën.
- **Shefki Berisha – Avonet:** Kërkoi sqarim lidhur me nenin 3 dhe 6 të projekt-rregullores, konkretisht për mënyrën se si është përcaktuar numri i licencave dhe mbi çfarë baze është marrë një vendim i tillë.
- **Rexhep Demolli – Golden Taksi:** Shprehu shqetësimin për dhënien e licencave të reja, duke theksuar se aktualisht ekzistojnë gjashtë kompani që tashmë kanë mungesë të shoferëve dhe mund të mbulojnë nevojat ekzistuese pa shtim të operatorëve të rinj.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- **Hilmi Canolli – Teslla:** Nënvizoi se kishte aplikuar një vit më parë për leje funksionimi, por nuk kishte marrë përgjigje. Kërkoi sqarim nëse duhet të përsëritet aplikimi apo do të merret në shqyrtim kërkesa ekzistuese.
- **Korab Demolli – Golden Taksi:** Propozoi që të mundësohet shtimi i numrit të veturave në kuadër të kompanive ekzistuese deri në 30, pa e rritur numrin e operatorëve të rinj në treg.
- **Skënder Ismajli – Autotaksi:** Parashtrroi nevojën që të arrihet një marrëveshje për çmimet e shërbimit të taksive, në mënyrë që të sigurohet stabilitet ekonomik për operatorët dhe cilësi për qytetarët.
- **Avdullah Sejdiu – Autotaksi:** Kërkoi që të vendosen shenja të posaçme për automjetet autotaksi në qytet, duke theksuar vështirësitë aktuale në mungesë të këtyre sinjalizimeve.

Përfaqësuesit institucionalë ofruan sqarime për çdo nen të diskutuar, duke theksuar që qëllimi i rregullores është rritja e sigurisë në transport, barazia në konkurrencë dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

U theksua gjithashtu se të gjitha komentet e pranuar gjatë konsultimit do të shqyrtohen dhe, nëse është e arsyeshme, do të integrohen në versionin përfundimtar të rregullores para dërgimit për miratim në Kuvendin Komunal.

Takimi përfundoi me vlerësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve dhe operatorëve të transportit, si dhe me zotimin për të vazhduar komunikimin konstruktiv në të mirë të qytetarëve dhe zhvillimit të kësaj veprimtarie në mënyrë të rregulluar dhe transparente.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi